

**Nr. Prot. 015/B/20****VENDIMI Nr. 1550****Për****Revokimin e Autorizimeve të Përgjithshme për  
Ofruesit Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike**

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 7) dhe paragrafi 14), nenit 16, nenit 17, nenit 18 dhe nenit 79, paragrafi 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar; Ligji ose LKE*); nenit 7 dhe nenit 8 të Rregullores Nr. 37 për Autorizimet e Përgjithshme (*Ref. ARKEP Nr. Prot. 019/B/18 - tutje referuar; Rregullorja*); në përputhje me dispozitat e nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr. Prot. 054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 3) z. Bahri Anadolli, Anëtar
- 4) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më datë: 28 Shkurt 2020, pas shqyrtimit të raportit të shkresave të lëndës unanimisht vendosi si më poshtë:

**V E N D I M**

- I. Revokohen Autorizimet e Përgjithshme/Konfirmimet të lëshuara nga Autoriteti për ndërmarrjet si në vijim:

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Nr. Prot. i Konfirmimit	Dt. e Konf. të Njoftimit	Nr. Regj. të Biznesit
1	N.T. "Banana"	311/A/14	2/12/2014	70446417
2	POWER NET sh.p.k.	119/A/17	30/06/2017	810036162
3	KO GROUP SH.P.K.	046/A/16	29/02/2016	71016870
4	KOSbit	050/A/16	14/03/2016	71022463
5	N.T. Sh. "ONE"	112/A/14	10/3/2014	70973146

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Nr. Prot. i Konfirmimit	Dt. e Konf. të Njoftimit	Nr. Regj. të Biznesit
6	PimiPhone1	049/A/15	24/03/2015	70792109
7	PR MEDIA SH.P.K	195/A/17	23/10/2017	71292525
8	Tre Media sh.p.k.	006/A/15	16/01/2015	71110796
9	UNIVERS Sh.P.K.	110/A/14	10.03.2014	70959143
10	“Shqip4u” gmbh	037/A/17	23/02/2017	71353826

- II.** Autorizimet e revokuara në pikën I të këtij aktvendimi do të fshihen nga Regjistri i ndërmarrjeve që kanë kryer procedurat e njoftimit dhe autorizimet nuk do të kenë efekt juridik nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- III.** Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

### ARSYETIMI

Ndërmarrjet e specifikuar në dispozitiv të këtij vendimi nuk kanë kryer obligimin për raportimin vjetor financiar në ARKEP siç kërkohet me Ligj me gjithë faktin se ARKEP ka njoftuar për këto obligime.

Duke pasur parasysh faktin se ndërmarrjet nuk kanë raportuar edhe pas dërgimit të vërejtjeve përfundimtare, atëherë ARKEP me autorizimin e datës 18/09/2019 (Ref. Nr.Prot.106/1/19) ka formuar komisionin dhe autorizuar inspektimin për të gjitha ndërmarrjet, të cilat nuk kanë raportuar. Gjatë inspektimit Komisioni ka vizituar të gjitha lokalet e ndërmarrjeve të lartcekura dhe është konstatuar se kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre, respektivisht nuk kanë kryer raportimin edhe pas dërgimit të vërejtjes. Pas inspektimit, komisionet kanë përgatitur raportet e tyre, të cilat janë shqyrtuar nga Bordi i ARKEP.

Duke pas parasysh atë që u tha më lartë dhe bazuar në nenin 10, paragrafi 7 i Ligjit përcakton se Autoriteti: *“Monitoron dhe rregullon dispozitat e komunikimeve elektronike publike të rrjetave dhe shërbimeve.”*

Neni 18, paragrafi 1) i Ligjit përcakton se: *“ Ndërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike detyrohen t’i japin të dhëna dhe çdo informacion tjetër, të kërkuar nga Autoriteti, në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga ky ligj”.*

Në bazë të nenit 7, paragrafi 1) i Rregullores përcaktohet se: *“Në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti, ndërmarrësit janë të detyruar që të dërgojnë pranë Autoritetit të dhënat dhe raportet për veprimtarinë e tyre.”*

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1) i Rregullores përcakton se: *“Kur ndërmarrësi mbyll aktivitetin e njoftuar dhe të regjistruar nga Autoriteti, ajo është e detyruar të njoftojë Autoritetin brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e mbylljes sipas formularit në Shtojcën I. Autoriteti pasi verifikon plotësimin e detyrimeve ligjore të ndërmarrësit bën çregjistrimin e tij nga regjistri.”*

Andaj, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi.

**Prishtinë, 28/ 04/ 2020**

### **Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Ndërmarrjeve, të lartcekura
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP
- Departamentit Ligjor, ARKEP
- Arkivit të ARKEP;